



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 53, datë 6.2.2019



P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.325, DATË 19.3.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN
E RREGULLAVE PËR PRANIMIN NË VEPRIMTARINË
E OPERATORIT TË TRANSPORTIT RRUGOR TË MALLRAVE
DHE TË UDHËTARËVE, SI DHE PËR NJOHJEN E DOKUMENTEVE
ZYRTARE TË CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË"¹,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, "Për transportet rrugore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në rregulloren që i bashkëlidhet vendimit nr.325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

I. Kudo në tekst, emërtimi "Qendra Kombëtare e Licencimit" dhe termi "QKL" zëvendësohen përkatësisht me "Qendra Kombëtare e Biznesit" dhe "QKB".

II. Në kapitullin II bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "a", e pikës 5.2, riformulohet, si më poshtë vijon:

"a) Jo më pak se 9 000 (nëntë mijë) euro, për mjetin e parë, dhe 5 000 (pesë mijë) euro, për çdo mjet shtesë të autorizuar për t'u përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;"

2. Pika 5.4 riformulohet, si më poshtë vijon:

¹ Ky vendim është i përafëruar pjesërisht me rregulloren (KE) nr.1071/2009, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, "Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE", nr.CELEX 32009R1071, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian L300, 14.11.2009, faqe 51-71.

5.4. Kushti në lidhje me kapitalin minimal të vlefshëm dhe rezervë të qëndrueshmërisë financiare të veprimtarisë së ndërmarrjes në transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve, i përcaktuar sipas shkronjës “a”, të pikës 5.2, do të zbatohet nga data 1 mars 2019.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË**

BELINDA BALLUKU

Λ.PROT. 292/1
DATE 0.2. 2019

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE
TË TRANSPORTIT RRUGOR
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

